

AKTI I THEMELIMIT
(I SHOQERISE ANONIME)

Duke u bazuar ne ligjin Nr. 7632, date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te kodit tregtar"; ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"; si dhe ne ligjin Nr.7667, date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare une ZAIM HOXHAI i date lindjes 07.04.1963, lindur dhe banues ne komuna Mjede, rrethi Shkoder me vullnetin tim te lire te cilin e shprehi dhe ne nenshkrimin e ketij akti, THEMELOJ shoqerine " LAND-FJORI GAZ "sh.a.

LLOJI I SHOQERISE

Kjo shoqeri do te jete "Shoqeri Tregtare" e formes "Shoqeri Anonime" (Sh.A.)

EMERTIMI TREGTAR

Emertimi i shoqerise eshte "LAND-FJORI GAZ"

Ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe dalin nga shoqeria emertimi i saj do te paraprihet (ose te ndiqet menjehere) nga inicialet "SH.A". Shoqeria ka dhe vulen e saje drejte kendore ne te cilen shkruhet "LAND-FJORI GAZ sh.a. Eksport-Impoer. Shkoder Albania".

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte PA AFAT.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie eshte:

1. Tregtimi me shumice e pakice, eksport-import te artikujve te ndryshem industrial (kancelari dhe artikuj shkollore, etj), i artikujve ushqimore, hidrosanitare, goma makinash, materiale ndertimi, elektroshtepiake, elektrike, tekstile dhe konfeksione, makineri e paisje. Hapje rrobaqepsie.
2. Prodhim e tregtim me shumice e pakice te konfeksioneve te ndryshme, te gatshme e gjysem te gatshme, blerjen e lendeve te para, ndihmese import-eksport, teknologji e paisje te konfeksioneve. Si dhe ambalazhimin dhe stampimin e tyre.
3. Tregtimi me shumice e pakice, import-export i hidrokarbureve, karburanteve, vajra lubrifikante per makina, makineri, paisje dhe transformatore si dhe te gazit natyrore per ngrohje, gatim dhe per lende djegese per automobilet si dhe te gazit te lenget. Hapje pike karburanti me pakice (distributor).
4. Te gjitha llojet e projekteve dhe punimeve te ndertimit te parashikuara per tu licensuar nga ministria e puneve publike, transportit dhe telekomunikacionit.(Emertimi i ministrise varion sipas ndryshimeve qe peson me vone).
5. Mbareshtimi i pyjeve, prerja, perpunimi dhe tregtimi me shumice e pakice, import-eksport i lendes drusore.
6. Rritje bletesh dhe tregtim i mjaltit dhe nenprodukteve te tije.
7. Autoshkolle, agjensi e sherbimit te transportit te pasagjereve dhe te mallrave dhe transporti i tyre, taksi, sherbime urbane e interurbane, transpedicion, kolaudim te automjeteve, servis, parking. Tregtim te pjeseve te kembimit per autovetura, mjete transporti, atecature, tapiceri.
8. Shfrytezim terrenesh sportive siq jane fushat per ushtrimin e sporteve te ndryshme, ngritje dhe shfrytezim palestrash te ndryshme.
9. Prodhimi, perpunimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice import eksport i duhanit ne te gjitha format e perpunimit te tije si dhe ambalazhimi i produkteve te tije.
10. Hapje farmacie, si dhe tregtim me shumice dhe pakice import - eksport te barnave dhe ilaqeve.

11. Grumbullim, dhenie, shkëmbim informacioni në fushën e shitblerjeve, dhenieve me qera, të punësimit dhe çdo gjëje tjetër që lidhet me informacionin. Kryerje komisionerie dhe porosie. Hapje agjencie turistike udhëtimi e cila merret me kryerjen e shërbimeve turistike ndaj klienteve turistë vendas dhe të huaj, individual ose të organizuar në grupe, të programuara paraprakisht ose sipas dëshirës së klienteve turistë dhe kryesisht :

- -organizimi i udhëtimeve për pushime individuale ose kolektive
 - organizimi i pritje-percejeljes së turistëve, shërbimi i guides, perkthyesit, etj.
 - organizimi i vizitave në qytete, muze, monumente historike dhe kulturore, ekskursionë në natyrë, shfaqje dhe spektakle muzikor ose kulturor.
 - dhenia e informacioneve për udhëtime dhe pushime turistike.
- -rezervimi i vendeve të fjetjes në njesite akomoduese turistike, si dhe porositja e ushqimit në bar-restorante turistike.
- rezervimi i vendeve në mjetet e transportit turistik, ose venia në dispozicion të qera pjesore ose totale të këtyre mjeteve.
- -ndërmjetësimi me shërbimet kryesore të produktit turistik (tour-operatore).

12. Ushtrimi i aktivitetit si agjenci e transportit turistik.

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqërisë është caktuar Komuna Mjete, rrethi Shkoder. Ajo mund të transferohet në çdo vend tjetër të rrethit Shkoder ose të një rrethi tjetër.

Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme të aksionerëve.

Ndryshimi i selisë duhet të regjistrohet në zyrën e regjistrimit tregtar.


KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është caktuar në 15.550.000. (pesëmbëdhjetë milion e pesëqin e pesëdhjetë) leke të reja. Ai është i ndarë në 15.550 aksione me vlerë nominale 1000 leke për secilin dhe të numëtuara nga 1 deri . 15.550. Ai zotërohet 100% nga aksioneri i vetëm i shoqërisë ZAIM HOXHAI.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria administrohet nga drejtori i vetëm i cili është dhe aksioneri i vetëm i kësaj shoqërie ZAIM HOXHAI.

THEMELUESI
ZAIM HOXHAI



Republika e Shqipërisë
Zyra e Noterisë Shkoder
U. PABUJA. MIREA

Nr.Rep 116/3
Nr.Kol

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me datën 16.04.2017 në zyrën e Noterisë SHKODER dhe para meje noterit së kësaj zyre u paraqit personalisht themeluesi i mesiperm dhe unë pasi u sigurova për identitetin e tij në bazë të dokumentave të tij personal të identifikimit si dhe pasi u binda se ky ka votësi të plotë për të vepruar, vertetova nënshkrimin e mesiperm.

NOTERI

ELVIS ALIBAJ



STATUTI (I SHOQERISE ANONIME)

Duke u bazuar ne ligjin Nr. 7632,date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te kodit tregtar";ligjin Nr.7638,date19.11.1992 "Per shoqerite tregtare";si dhe ne ligjin Nr.7667,date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare une ZAIM HOXHAI i date lindjes 07.04.1963, lindur dhe banues ne komuna Mjede, rrethi Shkoder me vullnetin tim te lire nenshkruaj kete statut te shoqerise anonime.

NENI 1 : FORMA

Kjo shoqeri do te jete "Shoqeri Tregtare" e formes "Shoqeri Anonime" (Sh.A.)

NENI 2 : OBJEKTI

1. Tregtimi me shumice e pakice, eksport-import te artikujve te ndryshem industrial (kancelari dhe artikuj shkollore. etj), i artikujve ushqimore, hidrosanitare, goma makinash, materiale ndertimi, elektroshtepiake, elektrike, tekstile dhe konfeksione, makineri e paisje. Hapje rrobaqepsie.
2. Prodhim e tregtim me shumice e pakice te konfeksioneve te ndryshme, te gatshme e gjysem te gatshme, blerjen e lendeve te para, ndihmese import-eksport, teknologji e paisje te konfeksioneve. Si dhe ambalazhimin dhe stampimin e tyre.
3. Tregtimi me shumice e pakice, import-export i hidrokarbureve, karburanteve, vajra lubrifikante per makina, makineri, paisje dhe transformatore si dhe te gazit natyrore per ngrohje, gatim dhe per lende djegese per automobilet si dhe te gazit te lenget. Hapje pike karburanti me pakice (distributor).
4. Te gjitha llojet e projekteve dhe punimeve te ndertimit te parashikuara per tu licensuar nga ministria e puneve publike, transportit dhe telekomunikacionit.(Emertimi i ministrise varion sipas ndryshimeve qe peson me vone).
5. Mbareshtimi i pyjeve, prerja, perpunimi dhe tregtimi me shumice e pakice, import-eksport i lendes drusore.
6. Rritje bletesh dhe tregtim i mjaltit dhe nenprodukteve te tije.
7. Autoshkolle, agjensi e sherbimit te transportit te pasagjereve dhe te mallrave dhe transporti i tyre, taksi, sherbime urbane e interurbane, transpedicion, kolaudim te automjeteve, servis, parking. Tregtim te pjeseve te kembimit per autovetura, mjete transporti, atrecature, tapiceri.
8. Shfrytezim terrenesh sportive siq jane fushat per ushtimin e sporteve te ndryshme, ngritje dhe shfrytezim palestrash te ndryshme.
9. Prodhimi, perpunimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice import eksport i duhanit ne te gjitha format e perpunimit te tije si dhe ambalazhimi i produkteve te tije.
10. Hapje farmacie, si dhe tregtim me shumice dhe pakice import – eksport te barnave dhe ilaqeve.



11. Grumbullim, dhenie, shkëmbim informacioni në fushën e shitblerjeve, dhenie me qera, të punësimit dhe çdo gjëje tjetër që lidhet me informacionin. Kryerje komisionerike dhe porositje. Hapje agjensie turistike udhëtimi e cila merret me kryerjen e shërbimeve turistike ndaj klientëve turistë vendas dhe të huaj, individual ose të organizuar në grupe, të programuara paraprakisht ose sipas dëshirës së klientëve turistë dhe kryesisht :

- -organizimi i udhëtimeve për pushime individuale ose kolektive
- organizimi i pritje-percejeljes së turistëve, shërbimi i guides, përkthyesit, etj.
- organizimi i vizitave në qytete, muze, monumente historike dhe kulturore, ekskursione në natyrë, shfaqje dhe spektakle muzikor ose kulturor.
- dhenia e informacioneve për udhëtime dhe pushime turistike.
- -rezervimi i vendeve të fjetjes në njesitë akomoduese turistike, si dhe porositja e ushqimit në bar-restorante turistike.
- rezervimi i vendeve në mjetet e transportit turistik, ose venia në dispozicion me qera pjesore ose totale e këtyre mjeteve.
- -ndermjetesimi me shitësit kryesore të produktit turistik (tour-operatore).

12. Ushtrimi i aktivitetit si agjensie e transportit turistik.

NENI 3 : EMERTIMI

Emertimi i shoqërisë është "LAND-FJORI GAZ"

Në të gjitha aktet dhe dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose të ndiqet menjëherë) nga inicialet "S.H.A" . Shoqëria ka dhe vulën e sajë drejtkëndore në të cilën shkruhet "LAND-FJORI GAZ sh.a. Eksport-Import, Shkoder Albania".

NENI 4 -- VENDODHJA E SELISE

Selia e shoqërisë është caktuar në Shkoder : Komuna Mjete, rrethi Shkoder.

NENI 5 - KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është PA AFAT.

NENI 6 - KONTRIBUTET

Kontributet janë në natyrë të shlyera tërësisht

Në momentin e themelimit në shoqëri janë vënë kontribute për një shumë prej 15.550.000. (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë) leke të reja. Ai është i ndarë në 15.550 aksione me vlerë nominale 1000 leke për secilin dhe të numëtuara nga 1 deri 15.550., aksione këto të nënshkruara dhe të shlyera tërësisht nga aksioneri i vetëm Zaim Roxhaj si shpërblim të kontributit në natyrë që ai ka vënë në shoqëri. Vlerësim ky i bërë në bazë të raportit të Znj. NURIE KRIMI ekspert kontributësh i caktuar në kushtet ligjore. Raport ky që i është bashkëlidhur çdo origjinali të këtij statuti.

Tërsia e kontributeve të treguara me sipërperbejnë kapitalin themelues të shoqërisë.

NENI 7 – KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte caktuar ne 15.550.000. (pesembedhjete milion e peseqin e pesedhjete) leke te reja. Ai eshte i ndare ne. 15.550 aksione me vlere nominale 1000 leke per secilin dhe te numertuara nga 1 deri . 15.550. Ai zoterohet 100% nga aksioneri i vetem i shoqerise ZAIM HOXHAIJ

NENI 8 – SHITJA DHE TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Aksionet jane te tregtueshme me pelqimin e shoqerise
Pervec rastit te trashegimise transferimi i pronesise mbi aksionet, nje personi jo-aksionar, pavaresisht nga baza juridike e ketij transferimi, duhet te miratohet nga Keshilli Mbikqyres ne kushtet dhe sipas procedurave te parashikuara nga neni 207 i ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 9. DREJTORIA PERBERJA DHE EMERIMI

Drejtimi i pergjithshem i shoqerise kryhet nga Drejtoria, e cila perbehet nga nje anetare, detyrimisht person fizike.

Anetari e Drejtorise emerohen nga Keshilli Mbikqyres. Asnje anetar i drejtorise nuk mund te beje pjese ne keshillin mbikqyres te shoqerise.
Drejtoria i ushtron funksionet nen kontrollin e Keshillit Mbikqyres.

NENI 10. KOHEZGJATJA E FUNKSIONEVE TE DREJTORISE

Drejtoria emerohet per nje periudhe prej kater vjetesh. Anetaret e saj jane te rizgjedhshem.

NENI 11. FUNKSIONIMI I DREJTORISE

Drejtoria duhet te informohet periodikisht per vendimet e anetareve te saj qe kane marre detyra te veçanta.

Ne marredhenie me te tretet shoqeria perfaqesohet nga drejtori.

NENI 12. MBLEDHJET E DREJTORISE DHE VENDIMET

Drejtoria mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise. Thirrja e mbledhjes behet me çdo menyre.

NENI 13. KOMPETENCAT E DREJTORISE

Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar me çdo rrethane ne emer te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji ua ka dhene shprehimisht keshillit mbikqyres dhe asamblese se aksionereve.

Drejtoria i ushtron kompetencat e veta brenda objektit te shoqerise.



Ne marrdhenie me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorise edhe kur keto akte nuk kane te bejne me objektin e shoqerise perveç kur provon se te tretet e dinin apo nuk mund te mos e dinin se keto akte ishin jashte objektit te shoqerise.

Megjithate ne cilesine e masave te rregullit te brendshem qe nuk u kundervihen te treteve per perfundimin e operacioneve te renditura me poshte drejtoria vepron me autorizim paraprak te keshillit mbikqyres.

- a) Dhenia e dorezanive dhe e garancive
- b) Kryerja e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor
- c) Hapja e veprimtarise ose degeve te reja, shkrija, bashkimi, dhe mbyllja teresisht ose pjeserisht e veprimtarive dhe degeve te shoqerise.
- d) Pjesemartja ne shoqeri te tjera te krijuara ose per t'u krijuar.
- e) Shitja dhe shkembimi i pasurive qe perbejne aktive te qendrueshme te shoqerise.
- f) Negocimi, perfundimi a ndryshimi i çdo kontratoje me afat ose per nje shume mbi kufijte e caktuar çdo vit nga heshilli mbikqyres.

Kur nje operacion kerkon autorizimin e Keshillit Mbikqyres dhe ky i fundit e refuzon kete, drejtoria mund te therrese asamblene e pergjithshme dhe i parashtron asaj çeshtjen. Asambleja e pergjithshme vendos per kryerjen ose jo te operacionit.

NENI 11. KESHILLI MBIKQYRES

Keshilli mbikqyres perbhet nga tre anetare.

Dy te tretat e anetareve te keshillit mbikqyres emerohen nga mbledhja e zakonshme e asamblese, kurse nje e treta zgjidhet nga te punesuarit ne shoqeri, perveç keshillit fillestar.

Anetaret e keshillit mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit duhet te kene nje kontrate pune me shoqerite te pakten pese vjet perpara zgjidhjes dhe kontrata t'i pergjigjet nje punesimi efektiv. Ne rastin kur numri i ketyre anetareve eshte tre, kuadrot dhe specialistet kane dy vende ne keshillin mbikqyres.

Sipas nenit 93 te ligjit 7638 meqe ky eshte keshilli i pare mbikqyres, anetaret caktohen drejtperdrejte ne statut.

NENI 15. KRYETARI DHE ZEVENDESKRYETARI I KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres zgjedh nga gjiri i tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar qe ngarkohen me mbledhjen e keshillit dhe drejtimin e debatit gjate seancave te tij. Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres jane detyrimisht persona fizike. Ata ushtrojne funksionet e tyre gjate periudhes se mandatit ne Keshillin Mbikqyres. Kryetari dhe zevendes kryetari i Keshillit Mbikqyres jane te rizgjedhshem. Keshilli Mbikqyres mund te emeroje nje sekretar te zgjedhur midis anetareve te keshillit ose jashte tyre duke caktuar koberzgatjen e funksioneve te ketij.

NENI 16. Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres, Quorumi dhe shumica per marrjen e vendimeve

Keshilli Mbikqyres mblidhet me thirrjen e kryetarit, ose ne rast pengimi te ketij, te zevendeskryetarit, sa here qe e kerkon interesi i shoqerise dhe te pakten nje here ne tre muaj per te degjuar raportin e drejtorise.

Thirrja e keshillit behet me te gjitha menyrat.

Kryetari i Keshillit mbikqyres duhet te therrase mbledhjen e keshillit brenda nje afati prej 15 ditesh kur te pakten nje anetar i drejtorise ose nje e treta e anetareve te Keshillit.

Mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete. Neqoftese kerkeses nuk i jepet udhe autoret e saj mund te procedojne vete ne thirrjen e mbledhjes se Keshillit Mbikqyres duke treguar rendin e dites se mbledhjes.

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres mbahen ne seline e shoqerise.

Rendi i dites vendoset nga kryetari ose, ne mungese te tij nga zevendeskryetari, ose nga anetari i drejtorise apo anetaret e Keshillit Mbikqyres qe kane kerkuar thirrjen e mbledhjes.

Çdo anetar i keshillit mbikqyres mund t'i jap mandat nje anetari tjetër per ta perfaqesuar ne nje seance te keshillit. Çdo anetar mund te jape vetem nje mandat per te njejten seance.

Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit mbikqyres jane te vlefshme kur numri i anetareve te pranishem ne mbledhje eshte te pakten sa gjysma e anetareve ne funksion.

Vendimet merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem dhe te perfaqesuar.

Ne rast votash te barabarta ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Ne seline e shoqerise mbahet nje regjister i pranise i cili firmoset nga anetaret e keshillit pjesemarrës ne seance.

Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit mbikqyres evidencohen me procesverbale te hartuara ne nje regjister te posaçem, i numertuar dhe i vulosur, qe mbahet ne selite e shoqerise, ne te cilin tregohen anetaret e pranishem, te perfaqesuar dhe qe mungojne, si dhe çdo person qe ka sistuar ne mbledhje, teresisht apo pjeserisht.

Procesverbalet firmosen nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga nje anetar i keshillit.

NENI 17. KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres ushtron kontrollin e perhereshem te drejtimit dhe administrimit te shoqerise nga ana e drejtorise.

Ai vendos per operacionet qe duhet te kryhen me autorizim te tij ne baze te nenit 21 te ketij statuti.

Keshilli mbikqyres miraton strukturen organizative te shoqerise dhe ndryshimet e saj, kriteret e punesimit dhe te pagave si dhe rregulloren e brendeshme te shoqerise.

Ne çdo kohe te vitit keshilli mbikqyres kryen te gjitha verifikimet dhe kontrollimet qe ai i çmon te arsyeshme dhe ka te drejte te kerkoje te njihet me dokumentat qe ai i gjykon te nevojshme per permbushjen e funksioneve te tij. Njeher ne tre muaj ai merr nje raport te paraqitur nga drejtoria.

Brenda tre muajve nga mbyllja e çdo viti financiar drejtoria i paraqit atij me qellim verifikimi dhe kontrolli llogarite vjetore, si dhe nje raport te shkruar per gjendjen e shoqerise dhe aktivitetet e saj gjate vitit financiar te mbyllur.



NENI 18. INFORMIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT

Çdo anetar i keshillit mbikqyres ka te drejte te kerkoje dhe te marre nga drejtoria informacion per çeshtje te natyres administrative, teknike dhe financiare qe i mundesojne atij te verifikoje dhe gjykoje per kushtet ne te cilat zhvillohet veprimtaria e shoqerise dhe te jete plotesisht i qarte qe duhen marre apo qe do te merren nga ana e keshillit.

Kryetari i keshillit ka pergjegjesine per t'i vene anetaret e keshillit ne gjendje qe te marrin informacionet e kerkuara.

Çdo anetar i keshillit duhet te njoftohet personalisht per mbledhjet e keshillit dhe t'i vihen ne dispozicion ne seline e shoqerise apo t'i dergohen bashke me thirrjen dokument dhe raportet qe do te shqyrtohen ne mbledhje.

Shoqeria nuk eshte i detyruar ti jape anetareve te keshillit te drejtuesve kopje te procesverbaleve te vendimeve te keshillit, per çdo anetar mund te kerkoje qe te njihet me to ne seline e shoqerise.

Mosnjohja e te drejtave te çdo anetari te keshillit per informacionet e mesiperme dhe mosthirrja ne mbledhjen e keshillit sjell pavlefshmerine e vendimeve te keshillit.

NENI 19. SHPERBLIMI I VEÇANTE PER PJESEMARRJEN NE KESHILL DHE SHPERBLIMET E JASHTEZAKONSHME

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mund t'u caktojë anetareve te keshillit mbikqyres si shperblim per pjesemarrjen ne keshill nje shume vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshueshme deri ne nje vendim te kundert te asamblese.

Keshilli mbikqyres mund te caktojë shperblime te jashtezakonshme per anetaret te cileve u ngarkohen misione apo u jepen mandate per sherbime apo detyra te caktuara.

Shperblimet e jashtezakonshme i nenshtrohen miratimit nga asambleja e pergjithshme zakonshme sipas rregullave te parashikuara nga nenet 122 deri 126 te ligjit "Per Shoqerite Tregtare"

Shperblimet e veçanta dhe te jashtezakonshme perballohen nga hlogaria e shoqerise dhe kalohen ne shpenzimet e saj.

Perveç shperblimeve te permendura ne kete nen, anetareve te keshillit nuk u caktohet asnje shperblim tjeter i perhereshem ose jo.

Emerohen si anetare te keshillit mbikqyres per nje kohe prej tre vjetesh

1. SHAQIR HOXHAI

2. VILMA HOXHAI

3. NAXHIJE HOXHAI

te cilet kane bere te ditur se pranojne funksionet respektive dhe pohojne se nuk jane prekur nga asnje papajtueshmeri apo ndalim qe pengon emerimin e tyre.

NENI 20. MARREVESHJET QE KERKOJNE AUTORIZIM

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe nje nga anetaret e drejtorise ose te keshillit mbikqyres, qe lidhet drejtperdrejte, apo me te cilen nje nga personat e siperpermendur lidhet direkt apo nepermjet nje personoi ndermjetes duhet te autorizohet paraprakisht nga keshilli Mbikqyres.

Kryetari i Keshillit Mbikqyres njofton ekspertin kontabel te autorizuar per marreveshjet e autorizuar nje muaj perpara se marreveshja te lidhet dhe i shtron keto marreveshje per miratim Asamblese se Pergjithshme.

Ekspertet kontabel te autorizuar i paraqitin Asamblese nje raport te posaçem per keto marreveshje, e cila vendos mbi kete raport.

Dispozitat e mesiperme nuk zbatohen per marreveshjet qe kane te bejne me operacionet rrjedhese dhe te kryera ne kushte normale.

NENI 21. MARREVESHJET E NDALUARA

Anetareve te drejtorise dhe te keshillit Mbikqyres, u ndalohet te kontraktojne qe te marrin hua nga shoqeria, t'u akordohet nga shoqeria nje zbulim ne llogari rrjedhese ose ne nje forme tjeter, si dhe te bejne shoqerine dorezenese apo garante per detyrimet e tyre ndaj te treteve. Ky ndalim zbatohet, gjithashtu, per bashkeshortin, paraardhesit dhe pasardhesit personave te permendur ne kete nen si dhe per çdo person ndermjetes.

NENI 22. DETYRIMI PER RUAJTJEN E SEKRETIT

Anetaret e drejtorise dhe te keshillit mbikqyres si dhe çdo person tjeter qe asiston ne mbledhjet e ketyre organeve duhet te ruajne fshehtesine per çeshtjet dhe te dhenat qe kane karakter te brendshem.

NENI 23. NATYRA E ASAMBLESE DHE KARAKTERI DETYRUES I VENDIMEVE.

Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen asamble te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre.

Çdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithë aksioneret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder.

NENI 24. THIRRJA DHE VENDI I ASAMBLESE

Asamblete e pergjithshme thirren nga Keshilli Mbikqyres ose nga drejtoria. Ato mund te thirren, gjithashtu, nga Eksperti kontabel i pavarur ne rast urgjence, nga nje mandatmbajtes i caktuar nga gjykata dhe, kur eshte rasti, nga likujduesi.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar me thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionereve behet me ane te njoftimit qe i dergohet çdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionereve apo te njihet prej tyre 15 dite perpara mbledhjes se asamblese dhe duhet te permbaje ditën, oren, dhe vendin e mbledhjes se asamblese, natyren e asamblese dhe rendin e dites.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi i kerkuar mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e



thirrjes se pare ne te njejtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes te mbledhjes se dyte rikujtojne daten dhe rendin e dites.

NENI 25 RENDI I DITES

Rendi i dites te mbledhjes se asamblese percaktohet nga autori i thirrjes. Nje ose disa aksionere qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te kapitalit themeltar te shoqerise kane te drejten te kerkojne qe te futen ne rendin e dites nje apo disa projektrezoluta.

Keto projektrezoluta dergohen ne seline e shoqerise te shoqeruara me nje kerkese ne te cilen tregohen edhe arsytet, si dhe me nje dokument qe provon zoterimin e pjeses se kapitalit themeltar te kerkuar nga paragrafi i dyte i ketij neni.

Projektrezolutat dhe dokumentet shoqeruese duhet te mberrijne ne seline e shoqerise te pakten 5 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre ne shqyrtim nje ceshtje qe nuk eshte e perishire ne rendin e dites. Megjithate ajo mundet, ne cdo rrethane, te shkarkoje nje ose disa anetare te Keshillit Mbikqyres dhe te beje zevendesimin e tyre.

NENI 26. QUORUMI, VOTIMI, NUMRI I VOTAVE

Ne asamblete e pergjithshme, te zakonshme dhe te jashtezakonshme, quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise.

E drejta e votes qe u perket aksionereve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Çdo aksioner i kapitalit i jep zoteruesit te pakten te drejten e nje vote. Votimi kryhet me doren ngritur, me thirrje emerore ose i fshehte sipas vendimit te komisionit te vezhimit dhe drejtuesit te mbledhjes se asamblese.

Votimi kryhet i veçante per çdo çështje apo vendim.

NENI 27. ASAMBLETE E PERGJITHSHME TE ZAKONSHME

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve te vitit pasardhes., per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per ushtrimin financiar te mbyllur.

Ajo ka midis te tjerash, kompetencat qe vijojne:

- te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te shoqerise
- te miratoje plan-biznesin dhe planin financiar vjetor
- te miratoje ndryshoje ose te hedhe poshte llogarite vjetore qe i jane shtruar per miratim
- te vendose per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit ne pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin
- te emeroje dhe shkarkoje anetaret e keshillit mbikqyres
- te emeroje Ekspertet ose Ekspertet Kontabel te autorizuar
- te miratoje ose te mos miratoje emerimet e anetareve te Keshillit Mbikqyres te kryera nga vete keshilli si emerime tye perkohshme
- te caktojte shperblimin e vecante dhe shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per keshillin mbikqyres

- te vendose per raportin e ekspertit kontabel te autorizuar lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te keshillit Mbikqyres

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim qe nuk sjell ndryshime ne statut.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50% per qind te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet per mbledhjen e dyte nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

NENI 28. ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E JASHTEZAKONSHME

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mblidhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti.

Ajo nuk mund te shtoje detyrimet e aksionereve pervec operacioneve qe rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten $\frac{3}{4}$ e aksioneve me te drejte vote. Per mbledhjen e dyte ky quorum eshte jo me pak se $\frac{1}{2}$ e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme merren me shumicen prej $\frac{3}{4}$ te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem.

NENI 29. EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR. EMERIMI DHE SHPERBLIMI

Asambleja e pergjithshme e aksionereve, cakton nje ekspert kontabel te autorizuar, te zgjedhur nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar

Ne caktimin e ekspert kontabel te autorizuar mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtuesmerite e percaktuara nga ligji "Per shoqerite tregtare"

Eksperti kontabel i autorizuar caktohet per nje kohe qe i pergjigjet nje ustrimi financiar.

Shperblimi i ekspertit kontabel te autorizuar te caktohet nga asambleja e aksionereve dhe perballohet nga shoqeria.

NENI 30. DETYRAT DHE TE DREJTAT

Detyrat dhe te drejtat e ekspertit kontabel te autorizuar te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare"

Asambleja e aksionereve mund t'i kerkoje ekspertit kontabel te autorizuar kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve te posaçme per çështje ne interes te shoqerise. Eksperteti kontabel i autorizuar thirret ne mbledhjen e drejtorise qe mbyll llogarite e vitit financiar te mbyllur si dhe ne te gjitha asamblete e aksionereve. Raportet qe ata pergatitin depozitohen ne seline e shoqerise, ne afatet e parashikuara nga ligji.

Emerohen si Eksperte Kontabel te autorizuar prej nje kohe prej tre vitesh financiare

1. Zonja NURIJE KRYMI.

E cila ka bere te ditur se pranon funksionet e tije dhe pohon se nuk eshte i prekur nga asnje papajtuesmeri apo ndalim qe pengon emerimin e tije.



NENI 31. INVENTARI. LLOGARITE VJETORE

Shoqeria mban nje kontabilitet te rregullt ne pajtim me ligjin. Ne mbyllje te cdo ushtrimi financiar Drejtoria harton inventarin e elementeve te ndryshem te aktivitet dhe te pasivitet ne kete date, si dhe llogarite vjetore te shoqerise.

Drejtoria harton raportin vjetor per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te mbyllur, ndryshimet e ardhshme te parashikueshem, ngjarjet e ndodhura midis dates kur eshte hartuar raporti, dhe veprimet e kerkinimit e te zhvillimit.

NENI 32. REZULTATI, CAKTIMI DHE SHPERNDARJA

Rezultati i veprimtarise percaktohet nga diferenca midis te ardhurave dhe te shpenzimeve, pas zbritjes te amortizimeve dhe te provizioneve. Nga fitimet e ushtrimit pasi te jene zbritur, kur eshte rasti, humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5% per te krijuar fondet e rezerves se domosdoshme. Kur kjo rezerve arrin 1/10 te kapitalit themeltar nuk behen me heqje nga fitimet e ushtrimit.

Fitimi i shperndashem formohet nga fitimi i ushtrimit duke hequr humbjet e meparshme dhe shumet e hequra per rezervat dhe duke shtuar fitimet e pa shperndara te trasheguara. Megjithkete, pas heqjes te shumave per tu kaluar ne rezerve ne zbatimte ligjit, asambleja e pergjithshme, mund te heqe cdo shume qe ajo e gjykon te pershtatshme per te krijuar rezerva te zakonshme ose te jashtezakonshme ose per ta mbartur shumen ne ushtrimin e ardhshem.

Fitimi i shperndashem qe mbetet shperndahet ndermjet aksionereve perpjestimisht me numrin e aksioneve qe i perkasin secilit.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose vendien ne shperndarje te shumave qe ajo heq nga rezervat qe ajo ka ne dispozicion. Megjithate dividendet caktohen ne radhe te pare nga fitimet e shperndashme te ushtrimit.

Perjashtuar rastin kur vendoset zvoglimi i kapitalit, aksionereve nuk mund t'u behet asnje shperndarje neqoftese si rrjedhoje e shperndarjes kapitalet e veta te shoqerise jane ose do te beheshin me te vogla se shumta e kapitalit te kerkuar me ligj plus rezervat qe nuk mund te shperndahen.

Ne qofte se eventualisht ndonje ushtrim financiar mbyllet me humbje, shumta e humbjes pas miratimit te llogarive vjetore nga asambleja, mbartet ne ushtrimin vijues, per t'u mbuluar nga fitimet e ushtrimeve te ardhshem deri ne shuarjen e saj.

NENI 33. MENYRAT E PAGIMIT TE DIVIDENTEVE . PARADHENIET

Asambleja e pergjithshme ka te drejte t'i jape cdo aksioneri per te gjitha ose per nje pjese te dividendeve nje opsion midis pagimit ne para dhe pagimit ne aksione.

Kerkesa per pagimin e dividendeve me aksione duhet te behet ne afatin e caktuar nga asambleja, i cili nuk mund te jete me shume se tre muaj nga data e vendimit te asamblese. Menyrat e pagimit te dividendeve ne para caktohen nga Asambleja e pergjithshme, ose ne mungese te saj, nga drejtoria. Pagimi i dividendeve ne para duhet te kryhet brenda nente muajve pas mbylljes te ushtrimit financiar, pervec ky afat zgjatet me vendim te gjykates. Drejtoria mund te vendose pagimin e dividendeve perpara mbylljes se ushtrimit ne forme paradhenie por me respektimin e kerkesave te parashikuara ne ligj.

NENI 34 PRISHJA. LIKUJDIMI

Perjashtuar rastin e nje prishje me vendim gjyqj te parashikuar nga ligji, shoqeria mund te prishet ne mbarim te afatit te caktuar ne statut ose me vendim te asamblese te pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve.

Perveç rastit te bashkimit ose te ndarjes prishja e shoqerise per cfaredo shkak qofte sjell likuidimin e saj. Likuidimi kryhet nga nje ose disa likuidatore te emeruar nga asambleja e pergjithshme e zakonshme ose nga asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme ne kushtet e quorumit dhe te shumices per asamblete e zakonshme.

Likuidatori perfaqeson shoqerine. Ai ka kompetenca te plota per te shitur aktivet e shoqerise, per te shlyer kreditoret dhe per te shperndare mbetjen e disponueshme.

Asambleja e pergjithshme e aksionereve mund ta autorizojë likuidatorin te vazhdoje ceshtjet ne proces ose te ndermarre ceshtje te reja per nevojat e likuidimit.


Aktivi neto i mbetur, pas shlyerjes te vleres nominale te aksioneve, ndahet midis aksionereve ne perpjestim me pjesemarrjen e tyer ne kapital.

Hartuar ne Shkoder me 15.01.2007.

Ne 4 (kater) ekzemplare .


THEMELUESI

ZAIM HOXHIAJ



Nr.Rep 115/3

Nr.Kol -



Republika e Shqiperise
Zyra e Noterise Shkoder
PRAGUA TAKSA

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me daten 16.01.07 ne zyren e Noterise SHKODER dhe para meje noterit se kesaj zyre u paraqit personalisht themeluesi i mesiperm dhe une pasi u sigurova per identitetin e tije ne baze te dokumentave te tije personal te identifikimit si dhe pasi u binda se ky ka zotesi te plote per te vepruar,vertetova nenshkrimin e mesiperm.

NOTERI

ELVIDA AUBALI

